



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje mjete eskavator për përballim përmbajtjes dhe rehabilitim emergjent, për nevojat e Bashkisë Divjakë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): (CPV): 43262000-7 Makineri eskavator.

VLERA E FONDIT LIMIT: 9,910,000 (nëntë milion e nëntëqind e dhjetë mijë) lekë pa Tvsh nga Granti.

Burimi i financimit: **Granti.**

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Divjakë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të veçanta për

kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t'i shërbejë Autoritetit Kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në nenin 40 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë vërtetim nga administrata tatimore për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vjetët e fundit financiarë 2023, 2024 dhe 2025 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter, është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Kerkesat per kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në piken 2/c citohet: 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndersa në piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor, ndersa në piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses

kontraten. Gjithashtu, vendosja e kriterëve ne reference, është bere që t'i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, ne nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, ne Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 *“Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë”* i ndryshuar, si edhe në Ligjin Nr.29/2023 *“Për tatimin mbi të ardhurat”* i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për te vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për te permbushur me sukses kontraten. Në përcaktimin e vlerës së xhiros, Autoriteti Kontraktor është referuar në pikën 2/c, të Nenit 43 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për te vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqese vërtetimet që dëshmojnë se ka paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”*, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2025 dhe kështu e maturuara të vitit 2026.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2026, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”.*

“Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, nenit 40, pika 8 dhe te nenit 43 të VKM Nr.285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne Ligjin Nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar. Meqënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendët që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 55, pika 4/b të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses, sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të së cilës, duhet të deklarojë, se mjeti i ofruar, është në përputhje me parametrat teknike të kërkuara për mjetin, si edhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat Standarde të Tenderit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Vendosija e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklarate, të vërtetojnë dhe garantojnë AK, se mjeti i ofruar, është në përputhje me parametrat teknike të kërkuara për mjetin, si edhe me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë garancie, me anë të së cilës deklarohen se mjeti i ofruar do të jetë i mbuluar me garanci teknike për një periudhë prej **12 (dymbëdhjetë) muajsh** nga data e marrjes në dorëzim përfundimtar nga Autoriteti Kontraktor, pas përfundimit të kolaudit dhe verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në deklaratë duhet të përcaktohen qartë termat dhe kushtet e garancisë. Gjatë periudhës së garancisë, Operatori Ekonomik merr përsipër, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor, riparimin ose zëvendësimin e çdo defekti apo mosfunksionimi që lidhet me cilësinë, materialet, komponentët, montimin ose funksionimin e mjetit, si dhe kryerjen e shërbimeve periodike të mirëmbajtjes të përcaktuara nga prodhuesi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Vendosija e këtij kriteri, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet paraqitjes së një deklarate, të garantojnë Autoritetin Kontraktor, se mjeti i ofruar, do të ketë garanci teknike minimumi 1 vit nga dita e marrjes në dorëzim të tij.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të së cilës të deklarohen se, mjetit objekt i procedurës së prokurimit, do të jetë i pajisur me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tij, sipas legjislacionit shqiptar dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Në çmimin e mjetit objekt i kësaj procedure prokurimi, përfshihen të gjitha shpenzimet për taksat doganore, regjistrimi, siguracioni, targat, kontrolli teknik, taksa, shpenzime noteriale për kalimin e pronësisë, etj, si dhe çdo shpenzim tjetër në funksion të qarkullimit të tij, siç përcaktohen në Ligjin Nr.8378 datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë të veprimtarisë, deri në dorëzimin e tij në destinacionin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet,

të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK. Kjo deklaratë, shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor, që malli objekt prokurimi, i cili do të dorëzohet pranë AK, do të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin teknik dhe ligjor shoqërues, për qarkullimin dhe përdorimin e tyre, sipas legjislacionit shqiptar, standardeve kombëtare e ndërkombëtare, në funksion të qarkullimit të tyre, konform Ligjit Nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë të veprimtarisë.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të së cilës të deklarojë se, mjeti duhet të jetë në gjendje të mirë motorrike, xhenerike dhe vizuale në pjesën e brendshme/jashtme dhe duke mos pasur dëmtime sidomos për sa i përket korrozionit, dëmtimet nga agjentët atmosferikë, rrjedhje të lëngjeve teknike, goditjet etj. Tubat e presionit të vajit, të jenë në gjendje të mirë (të pa gripuara). Gomat të jenë në gjendje të mirë (jo të konsumuara).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të pikës 8 të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben Autoritetit Kontraktor, për tu siguruar se operatori ekonomik pjesëmarrës, do të përmbushë kërkesat e AK.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

- **Eskavatori me goma me kova të ndryshme duhet të jetë me parametrat si më poshtë:**

1. Viti i prodhimit minimumi 2017.

Përcaktimi i vitit minimal të prodhimit lidhet me nevojën për të siguruar një mjet që të ketë një nivel të përshtatshëm të zhvillimit teknologjik, sigurie dhe eficiencë për përdorim operacional.

Një mjet i destinuar për Emergjencat Civile duhet të jetë në gjendje të përballojë punë intensive dhe të ndërhyjë në situata ku besueshmëria mekanike është thelbësore. Me kalimin e viteve, komponentët mekanikë dhe hidraulikë i nënshtrohen konsumimit, ndërsa rritet mundësia për ndërhyrje të shpeshta në mirëmbajtje.

Kërkesa për vitin minimal 2017 synon një ekuilibër ndërmjet kostos së blerjes së një mjeti të përdorur dhe nevojës për të pasur një makineri me moshë të përshtatshme, teknologji relativisht moderne, siguri më të lartë në operim dhe jetëgjatësi të mjaftueshme për përdorim nga struktura publike.

Ky kriter ndihmon gjithashtu në kufizimin e mjeteve tepër të amortizuara, të cilat mund të shkaktojnë ndërprerje të punës pikërisht në situata kur kërkohet reagim i menjëhershëm.

Kërkesa për vitin minimal 2017 lidhet edhe me nevojën që mjeti të ketë konfigurim teknik të përshtatshëm për parametrat e tjerë të kërkuar, veçanërisht për fuqinë e motorit, sistemin hidraulik, kapacitetin e punës dhe përdorimin e pajisjeve shtesë.

Një eskavator i destinuar për këto funksione duhet të jetë në gjendje të sigurojë presion dhe prurje hidraulike të përshtatshme për komandimin e krahut, kovave, kovës së pastrimit me pistonë dhe korrësës së vegjetacionit. Për këtë arsye, viti i prodhimit shërben si një nga kriteret teknike për përcaktimin e një mjeti të përshtatshëm për përmbushjen e kërkesave të performancës të përcaktuara në specifikime.

Gjithashtu, kërkesa synon të sigurojë përputhshmëri funksionale ndërmjet mjetit bazë dhe pajisjeve hidraulike të kërkuara, në mënyrë që eskavatori të mund të realizojë ciklet e gërmimit, ngarkimit, pastrimit dhe prerjes së vegjetacionit sipas destinacionit të tij operacional.

2. Orët e punës maksimumi (5000 orë).

Kufizimi në **maksimum 5,000 orë pune** synon sigurimin e një mjeti me **jetë operative të mbetur të mjaftueshme, besueshmëri dhe gatishmëri të lartë për përdorim të mëtejshëm.**

Orët e punës janë tregues i rëndësishëm i nivelit të shfrytëzimit të motorit, sistemit hidraulik, transmisionit dhe mekanizmave të krahut. Për një mjet që do të përdoret në **situata emergjente dhe punë intensive**, ky kufizim synon të reduktojë rrezikun e defekteve dhe ndërprerjeve të paparashikuara gjatë ndërhyrjeve.

Në këtë mënyrë sigurohet një **raport i përshtatshëm ndërmjet gjendjes së mjetit, kostove të mirëmbajtjes dhe jetëgjatësisë së pritshme operative.**

Nga pikëpamja teknike, orët e punës lidhen me numrin e cikleve të kryera nga komponentët kryesorë të mjetit. Rritja e orëve ndikon gradualisht në parametrat e punës së pompave hidraulike, cilindrave, nyjeve të krahut, kushinetave, transmisionit dhe komponentëve të tjerë që punojnë nën ngarkesë.

Kufiri prej 5,000 orësh synon që mjeti i ofruar të ruajë kapacitet të përshtatshëm për kryerjen e cikleve të përsëritura të **gërmimit, ngritjes, rrotullimit dhe shkarkimit**, si dhe për përdorimin e pajisjeve hidraulike me ngarkesa të ndryshueshme.

Ky kriter është veçanërisht i rëndësishëm për mjetin e kërkuar, pasi puna e parashikuar nuk kufizohet vetëm në gërmim, por përfshin edhe pastrimin e kanaleve dhe përdorimin e pajisjeve për prerjen e vegjetacionit.

3. Fuqia e motorit 100–110 HP.

Ky interval fuqie siguron kapacitet të mjaftueshëm për realizimin e operacioneve të gërmimit, ngarkimit, pastrimit të kanaleve, sistemimit të materialeve dhe përdorimit të pajisjeve hidraulike ndihmëse. Fuqia e përcaktuar garanton një raport optimal ndërmjet performancës, konsumit të karburantit dhe kostove të mirëmbajtjes.

Fuqia e motorit duhet të jetë e përshtatshme për të furnizuar sistemin hidraulik gjatë punës së njëkohshme të funksioneve të ndryshme të mjetit. Gjatë ciklit të gërmimit, fuqia e motorit transmetohet nëpërmjet sistemit hidraulik për komandimin e pompave, cilindrave të krahut dhe kovës, si dhe për lëvizjen dhe rrotullimin e mjetit.

Intervali **100–110 HP** siguron rezervën e nevojshme të fuqisë për punën me peshën operative 10–14 ton dhe me pajisjet e kërkuara, pa kërkuar një motor të dimensionuar mbi nevojat funksionale të mjetit.

4. Peshë operative 10–14 ton.

Peshë operative në këtë kategori i mundëson mjetit stabilitet gjatë punës, kapacitet të mjaftueshëm ngritës dhe forcë të përshtatshme gërmimi. Njëkohësisht ruan manovrueshmërinë e nevojshme për operim në rrugë rurale, zona urbane, kanale kulluese dhe ambiente me hapësira të kufizuara.

Peshë operative ndikon drejtpërdrejt në stabilitetin e mjetit gjatë ushtrimit të forcave të gërmimit dhe gjatë ngritjes së ngarkesave me krahun. Një peshë e përshtatshme siguron që forcat e krijuara nga kova dhe krahu të përballohen në mënyrë të qëndrueshme nga struktura e mjetit.

Intervali i kërkuar krijon raport të përshtatshëm ndërmjet **stabilitetit të bazës së mjetit, kapacitetit të ngritjes dhe ngarkesës së ushtruar mbi tokë**, duke e bërë mjetin të përshtatshëm për punime në terrene dhe kushte të ndryshme operative.

5. Lënda djegëse Naftë.

Kërkesa për motor me **lëndë djegëse naftë (Diesel)** përcaktohet nga karakteristikat e mjetit dhe kushtet e punës. Për një eskavator me fuqi **100–110 HP** dhe peshë **10–14 ton**, motori Diesel siguron **çift-rrotullim të lartë në regjime të ulëta, fuqi të qëndrueshme dhe eficiencë të përshtatshme** gjatë punës së sistemit hidraulik dhe pajisjeve të montuara.

Kjo është e nevojshme për operimin me **kova të ndryshme, korrëse vegjetacioni dhe pajisje hidraulike**, veçanërisht gjatë punës së vazhdueshme në gërmime, pastrimin e kanaleve dhe mirëmbajtjen e rrugëve në terrene të ndryshme.

Nga pikëpamja e transmetimit të fuqisë, motori Diesel është i përshtatshëm për kërkesat e një eskavatori sepse karakteristika e çift-rrotullimit mundëson përbalimin e ngarkesave të ndryshueshme gjatë ciklit të

punës. Kjo është e rëndësishme kur pompat hidraulike kërkojnë fuqi të ndryshme në varësi të rezistencës së materialit dhe funksionit të aktivizuar.

Përdorimi i motorit Diesel lidhet gjithashtu me nevojën për funksionim të qëndrueshëm gjatë cikleve të gjata të punës, ku motori duhet të furnizojë në mënyrë të vazhdueshme sistemin hidraulik dhe sistemet e lëvizjes së mjetit.

6. Norma e emetimit minimumi Tier 4 Final / Stage IV.

Përcaktimi i këtij standardi siguron përdorimin e teknologjisë moderne me emetime të reduktuara të gazrave ndotës, konsum më të ulët karburanti dhe përputhshmëri me kërkesat mjedisore në fuqi. Gjithashtu garanton efikasitet më të lartë të motorit dhe kosto më të ulëta operimi.

Kërkesa për këtë nivel emetimi lidhet me sistemet e kontrollit të gazrave të shkarkimit të motorit dhe me aftësinë e tij për të kufizuar emetimet e ndotësve gjatë funksionimit nën ngarkesë.

Duke qenë se mjeti do të përdoret edhe në zona të banuara dhe pranë infrastrukturës publike, performanca e motorit duhet të jetë në përputhje me nivelin mjedisor të përcaktuar në specifikim, duke ruajtur njëkohësisht fuqinë dhe karakteristikat e nevojshme të punës.

7. Lartësia e gërmimit 8.15–8.55 m.

Kjo lartësi pune është e nevojshme për ngarkimin e materialeve në mjete transporti, pastrimin e argjinaturave, kanaleve dhe kryerjen e operacioneve në terrene me konfigurime të ndryshme. Parametri siguron fleksibilitet në përdorim dhe produktivitet më të lartë.

Lartësia e gërmimit përcakton pozicionin maksimal vertikal që mund të arrijë pika e punës së kovës dhe është veçanërisht e rëndësishme gjatë ngarkimit të materialeve në mjete transporti ose gjatë ndërhyrjeve në struktura dhe argjinatura me kuotë më të lartë.

Intervali i kërkuar siguron që krah dhe pajisja e punës të kenë shtrirje të mjaftueshme për të realizuar ciklin e plotë të ngritjes dhe shkarkimit pa kufizime që do të reduktonin kapacitetin praktik të mjetit.

8. Thellësia e gërmimit 3.8–4.2 m.

Thellësia e kërkuar është e domosdoshme për pastrimin dhe rehabilitimin e kanaleve kulluese, hapjen e kanaleve të reja, riparimin e rrjeteve nëntokësore dhe kryerjen e ndërhyrjeve gjatë emergjencave të shkaktuara nga përmbytjet apo rrëshqitjet e dherave.

Thellësia e gërmimit përcakton aftësinë e krahut dhe pajisjes së punës për të arritur kuotat e nevojshme nën nivelin e terrenit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për seksionet e kanaleve ku materiali i depozituar duhet të hiqet deri në kuotën funksionale të shtratit.

Intervali **3.8–4.2 m** siguron kapacitet të mjaftueshëm për ndërhyrje në kanale me thellësi të ndryshme, duke ruajtur njëkohësisht përdorshmërinë e mjetit në punime të tjera.

9. Rrezja maksimale e gërmimit 7.15–7.55 m.

Kjo rreze pune mundëson ndërhyrje në zona të vështira për t'u aksesuar pa lëvizur vazhdimisht mjetin, duke rritur produktivitetin, sigurinë dhe efikasitetin e operacioneve.

Rrezja maksimale përcakton distancën horizontale në të cilën pajisja e punës mund të realizojë operacionin e gërmimit në raport me qendrën e rrotullimit të mjetit.

Një rreze e tillë pune është e nevojshme gjatë pastrimit të kanaleve dhe ndërhyrjeve në anë të rrugëve, ku pozicionimi i mjetit mund të kufizohet nga terreni, kanali ose infrastruktura ekzistuese. Rritja e shtrirjes së punës lejon mbulimin e një seksioni më të madh nga i njëjti pozicion i mjetit.

10. Tre kova gërmimi me kapacitete minimale 0.11 m³, 0.19 m³ dhe 0.31 m³.

Kovat me kapacitete të ndryshme janë të nevojshme për realizimin e punimeve të ndryshme sipas natyrës së ndërhyrjes. Kova më e vogël përdoret për punime precize pranë infrastrukturave ekzistuese, ndërsa kovat me kapacitet më të madh përdoren për gërmime, pastrim kanalesh dhe lëvizje materialesh me produktivitet më të lartë.

Ndryshimi i kapacitetit të kovës lejon përshtatjen e ngarkesës së punës me rezistencën e materialit dhe hapësirën ku kryhet ndërhyrja. Kovat me kapacitet më të vogël janë më të përshtatshme kur kërkohet kontroll më i madh i materialit të hequr, ndërsa kapacitetet më të mëdha rrisin volumin e materialit të trajtuar për cikël.

Përdorimi i disa kapaciteteve redukton nevojën për kompromis ndërmjet **forcës së gërmimit, volumit të materialit dhe saktësisë së punës**, duke lejuar konfigurimin e pajisjes sipas llojit të ndërhyrjes.

11. Kova e pastrimit të kanaleve me pistonë, me kapacitet minimumi 0.45 m³.

Kjo pajisje është e domosdoshme për pastrimin, profilizimin dhe sistemimin e kanaleve kulluese dhe vaditëse. Mekanizmi i animit hidraulik mundëson punime me saktësi më të lartë dhe rrit ndjeshëm produktivitetin gjatë mirëmbajtjes së rrjetit kullues.

Pajisja me pistonë hidraulikë mundëson ndryshimin e këndit të kovës gjatë ciklit të punës, duke lejuar përshtatjen e saj me pjerrësinë dhe profilin e kanalit pa ndryshuar pozicionin e bazës së mjetit.

Kapaciteti minimal **0.45 m³** siguron volum të përshtatshëm për largimin e materialit të depozituar, ndërsa komandimi hidraulik lejon kontroll më të mirë gjatë profilizimit të shtratit dhe skarpatave të kanalit.

12. Korrëse për pastrim/prerje vegjetacioni me gjerësi pune minimumi 160 cm.

Korrësja është e nevojshme për mirëmbajtjen e kanaleve, argjinaturave, anëve të rrugëve dhe sipërfaqeve publike. Gjerësia minimale prej 160 cm mundëson mbulimin e një sipërfaqeje më të madhe pune dhe ul kohën e ndërhyrjes.

Gjerësia e punës prej minimumi 160 cm përcakton sipërfaqen efektive të trajtuar në një kalim të pajisjes. Një gjerësi e tillë është e përshtatshme për ndërhyrje përgjatë skarpatave, anëve të rrugëve dhe zonave të kanalizuar, ku kërkohet pastrim në një brez pune të vazhdueshëm.

Kjo karakteristikë ndikon drejtpërdrejt në kapacitetin sipërfaqësor të punës dhe në numrin e kalimeve të nevojshme për përfundimin e një seksioni.

13. Aftësi prerëse për vegjetacion me diametër deri në 10 cm.

Kjo kërkesë siguron që pajisja të jetë e aftë të eliminojë jo vetëm barishtet dhe shkurret, por edhe vegjetacionin drunor që pengon rrjedhjen e ujërave, qarkullimin ose funksionimin normal të infrastrukturës.

Diametri maksimal i prerjes lidhet me kapacitetin mekanik të mekanizmit prerës dhe me ngarkesën që ai mund të përballojë gjatë kontaktit me materialin drunor.

Kërkesa deri në **10 cm** siguron që pajisja të mund të trajtojë një gamë më të gjerë të vegjetacionit të padëshiruar, pa kufizuar përdorimin e saj vetëm në bimësi të imët. Kjo rrit kapacitetin funksional të pajisjes gjatë mirëmbajtjes periodike të kanaleve dhe rrjetit rrugor.

14. Linja hidraulike për pajisje të ndryshme pune.

Prania e linjave hidraulike shtesë është e domosdoshme për përdorimin e pajisjeve të ndryshme si korrëse vegjetacioni, kapëse materialesh dhe aksesore të tjerë. Kjo rrit ndjeshëm funksionalitetin e mjetit.

Linjat hidraulike duhet të mundësojnë transmetimin e prurjes dhe presionit të kërkuar nga pajisjet e montuara, në mënyrë që aksesoret të funksionojnë brenda parametrave të tyre të punës.

Kjo kërkesë është veçanërisht e rëndësishme për pajisjet me motor ose cilindrat hidraulikë, ku performanca e aksesorit varet drejtpërdrejt nga furnizimi hidraulik i mjetit bazë.

15. Sistem kapjeje të shpejtë.

Sistemi i kapjes së shpejtë mundëson ndërrimin e aksesorëve në kohë shumë të shkurtër, pa përdorimin e mjeteve shtesë dhe pa ndërprerje të gjata të procesit të punës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme gjatë situatave emergjente.

Sistemi duhet të sigurojë lidhje mekanike të qëndrueshme ndërmjet krahut dhe pajisjes së punës dhe të lejojë kalimin nga një aksesor në tjetrin pa çmontim manual të lidhjeve kryesore.

Kjo mundëson konfigurimin e shpejtë të mjetit sipas llojit të punës dhe redukton kohën jo-produktive ndërmjet operacioneve, veçanërisht kur kërkohet kalim nga kova e gërmimit në kovën e pastrimit ose në pajisjen e prerjes së vegjetacionit.

16. Thikë përpara.

Thika e përparme është e nevojshme për nivelimin e terrenit, largimin e materialeve të depozituara nga përmytjet, sistemimin e dherave, hapjen e kalimeve emergjente dhe stabilizimin e mjetit gjatë punës. Pajisja rrit ndjeshëm kapacitetet operative të eskavatorit dhe redukton nevojën për makineri shtesë.

Thika e përparme funksionon si pajisje mbështetëse dhe niveluese, duke mundësuar ushtrimin e forcës horizontale mbi materialin e grumbulluar dhe rregullimin e sipërfaqes së terrenit.

Gjatë punës me krahun e eskavatorit, thika mund të përdoret për të krijuar një pikë mbështetjeje më të qëndrueshme të mjetit, ndërsa gjatë punimeve të sistemit mundëson shtyrjen dhe nivelimin e materialeve të lirshme. Kjo e bën pajisjen funksionale edhe në ndërhyrje ku kërkohen njëkohësisht punime gërmimi dhe sistemimi.

17. Eskavatori me goma.

Konfigurimi me goma është zgjedhur për shkak të lëvizshmërisë së lartë në rrjetin rrugor. Mjeti mund të lëvizë shpejt nga një zonë emergjence në tjetrën pa pasur nevojë për transport me rimorkiator, duke reduktuar kohën e reagimit dhe kostot operative të Bashkisë.

Nga pikëpamja funksionale, konfigurimi me goma është i përshtatshëm për një mjet që duhet të kryejë ndërhyrje në pika të ndryshme të territorit dhe të lëvizë ndërmjet tyre nëpërmjet rrjetit rrugor.

Ky konfigurim mundëson kombinimin e **punës së eskavatorit me lëvizjen autonome në rrugë**, duke shmangur ndërprerjet që do të krijoheshin nga nevoja për ngarkim dhe shkarkim të vazhdueshëm në një mjet transportues. Për këtë arsye, zgjedhja e konfigurimit me goma lidhet drejtpërdrejt me kërkesën funksionale për **reagim të shpejtë, zhvendosje të shpeshta dhe përdorim të mjetit në zona të ndryshme të territorit**.

Shënim:

- Mjeti objekt i procedurës së prokurimit do të pranohet (do të merret në dorëzim përfundimtar pas kolaudimit), nga një komision i posacëm i ngritur nga autoriteti kontraktor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Afati i kolaudimit do të jetë (prova, testime në terren) jo më shumë se 7 ditë kalendarike ose 5 ditë pune.
- Operatori ekonomik duhet ti kryej të gjitha shërbimet teknike të mjetit (vaj, filtra, etj.) në prani të komisionit të marrjes në dorëzim në ditën e parë të provës.

***Shënim: Në respektim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.**

***Shënim: Në kuptim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN/ISO, mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.**

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Specifikimet teknike, për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara, si edhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë

19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi, janë hartuar duke u diktuar nga nevoja gjithmonë e në rritje për mjete të cilat ndihmojnë stafin e AK, në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

GRAFIKU I LËVRIMIT TË MALLIT

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1.	Eskavator me goma me kova të ndryshme	9,910,000 (nëntë milion e nëntëqind e dhjetë mijë) lekë pa Tvsh	Në magazinën e Bashkisë Divjakë	45 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës

Afatet e lëvrimit: Afati i dorëzimit të mallit është brenda **45 ditëve** nga momenti i nënshkrimit të kontratës.